

**RELACION**  
**MBI**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**

**“KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE ADMINISTRIMIN E FONDIT TË  
GJELBËR TË PEMËVE NË KUADËR TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN**

Me ndryshimet e fundit ligjore në ligjin nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, në pikën 6 të nenit 39, është parashikuar se subjekti zhvillues, pas lëshimit të dokumentit të lejes së ndërtimit i lind detyrimi për të mbjellë pemë, ndërsa në pikën 10 të po këtij neni përcaktohet se rregullorja përkatëse do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër ligjor, paraqitet e nevojshme hartimi i një akti nënligjor, me qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e këtij detyrimi, përfshirë procedurat, kriteret, mënyrën e përmbushjes, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit, në funksion të sigurimit të zbatimit efektiv të dispozitave ligjore.

Në këtë projektvendim është parashikuar, që procesi i planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të ndërhyrjeve në kuadër të Fondit të Gjellbër të Pemëve të realizohet nëpërmjet një bashkërendimi institucional ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, me qëllim garantimin e një qasjeje të unifikuar dhe të koordinuar në realizimin e ndërhyrjeve për shtimin dhe përmirësimin e hapësirave të gjelbra. Ky bashkëpunim ndërinstitucional synon të sigurojë efikasitet në zbatim, përdorim optimal të burimeve dhe përputhshmëri të ndërhyrjeve me prioritetet zhvillimin e territorit dhe nevojat publike.

Projektvendimi në fjalë synon të vendosë një mekanizëm të ri, të strukturuar dhe të detyrueshëm për integrimin e gjelbërimit në proceset e zhvillimit të

territorit, duke krijuar Fondin e Gjelbër të Pemëve si një instrument fizik dhe administrativ në funksion të politikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në kushtet e rritjes së intensitetit të ndërtimeve dhe presionit të shtuar mbi hapësirat urbane, është bërë e domosdoshme ndërhyrja përmes një akti nënligjor, që garanton një raport të balancuar ndërmjet zhvillimit ndërtimor dhe mbrojtjes së mjedisit, duke siguruar, që proceset e zhvillimit të mos cenojnë interesin publik në drejtim të cilësisë së jetës dhe hapësirave të gjelbëruara. Përmes këtij projektvendimi synohet të krijohet një raport i drejtë dhe proporcional ndërmjet përfitimit nga zhvillimi ndërtimor dhe detyrimit për të kontribuar në përmirësimin e mjedisit.

Një tjetër element me rëndësi të veçantë është krijimi i një regjistri elektronik të integruar në sistemin e-leje, i cili do të mundësojë gjurmueshmërinë e plotë të pemëve të mbjella, monitorimin e statusit të tyre dhe transparencën e të dhënave. Nga pikëpamja e ndikimeve, projektvendimi pritet të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin publik dhe mirëqenien e qytetarëve.

Po aq e rëndësishme është edhe mekanizmi i kushtëzimit të lëshimit të certifikatës së përdorimit me konfirmimin e përmbushjes së detyrimeve për mbjelljen e pemëve.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit si dhe mbrojtjes së mjedisit, duke reflektuar objektivat strategjike për rritjen e cilësisë së jetesës dhe për integrimin e standardeve mjedisore në politikat e zhvillimit.

Në këtë drejtim, projektvendimi përfaqëson një instrument, që lidh politikat e zhvillimit urban me ato të mbrojtjes së mjedisit, duke siguruar, që objektivat

strategjikë të mos mbeten në nivel deklarativ, por të përkthehen në detyrime konkrete dhe të matshme për subjektet përfituese nga zhvillimi i territorit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Analiza e zhvillimeve të fundit në sektorin e ndërtimit ka treguar se mungojnë dispozita konkrete, që të detyrojnë subjektet zhvilluese të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mjedisit.

Efektet e pritshme të projektvendimit janë afatgjata. Në planin mjedisor, pritet një rritje e konsiderueshme e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe një përmirësim i ndjeshëm i cilësisë së ajrit dhe mikroklimës urbane. Në planin social, rritja e hapësirave të gjelbra kontribuon drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqënies së qytetarëve. Në planin institucional projektvendimi forcon rolin e institucioneve përgjegjëse dhe përmirëson koordinimin ndërmjet nivelit qendror dhe atij vendor.

Zhvillimi intensiv i sektorit të ndërtimit ka nxjerrë në pah mungesën e mekanizmave të detyrueshëm dhe të unifikuar për integrimin e gjelbërimit në zhvillimin e territorit. Gjithashtu, kuadri aktual nuk garanton zbatim efektiv të detyrimeve për mbjelljen e pemëve, për shkak të mungesës së standardeve të matshme dhe të një sistemi të centralizuar monitorimi.

Projektvendimi vendos një raport të drejtpërdrejtë dhe proporcional ndërmjet zhvillimit ndërtimor dhe detyrimit për mbjellje, duke krijuar një mekanizëm të qartë dhe të zbatueshëm. Krijimi i Fondit të Gjelbër si fond fizik siguron realizimin konkret të detyrimeve dhe shmang formalizmin në zbatimin e tyre. Gjithashtu, zgjerimi i kontributit edhe për përdoruesit e hapësirave publike vendos një shpërndarje më të drejtë të barrës mjedisore.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 39 të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektakti nuk synon përafrimin me *acquis communautaire*.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përmban 10 nene, të cilat përcaktojnë rregullat e krijimit, funksionimit dhe administrimin e fondit të gjelbër të pemëve në kuadër të zhvillimit të territorit dhe hapësirave publike, konkretisht:

Në nenin 1 të projektvendimit parashikohet objekti dhe qëllimi i tij, duke përcaktuar rregullat për krijimin, funksionimin dhe administrimin e Fondit të Gjelbër të Pemëve, si një mekanizëm në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, që synon integrimin e gjelbërimit, rritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në hapësirat publike.

Në vijim, në nenin 2 parashikohet krijimi i Fondit si një fond fizik i përbërë nga fidanë dhe pemë për mbjellje, i cili administrohet në nivel qendror nga AZHT. Gjithashtu, përcaktohet përdorimi ekskluziv i fondit për mbjellje, rehabilitim dhe mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra, si dhe roli i AZHT-së në krijimin e stokut kombëtar, planifikimin e nevojave për gjelbërim dhe shpërndarjen e tyre në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Në nenin 3 trajtohet bashkëpunimi ndërinstitucional, duke përcaktuar përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore për identifikimin e hapësirave për mbjellje, zbatimin në terren dhe mirëmbajtjen e pemëve, si dhe rolin e AZHT-së në miratimin e zonave dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin për përcaktimin e llojeve të bimësisë në përputhje me kushtet territoriale.

Në nenin 4 parashikohet detyrimi i subjekteve zhvilluese, që pajisen me lejë ndërtimi, për të kontribuar në Fondin e Gjellbër të Pemëve me një numër të caktuar pemësh, sipas raporteve dhe kufijve të përcaktuar në këtë vendim, në varësi të tipologjisë dhe madhësisë së ndërtimit. Ky kontribut realizohet në formë fizike, përmes mbjelljes së fidanëve në zonat e përcaktuara, duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë midis zhvillimit të territorit dhe gjellbërimit.

Në nenin 5 parashikohet detyrimi për depozitimin e një deklarate përgjegjësie nga subjekti zhvillues përpara pajisjes me leje ndërtimi, si dhe kushtëzimi i lëshimit të certifikatës së përdorimit me verifikimin e përmbushjes së detyrimit për mbjelljen e fidanëve dhe pemëve.

Në nenin 6 përcaktohet detyrimi për të kontribuar në fond edhe nga subjektet që shfrytëzojnë hapësira publike, duke vendosur një raport të drejtpërdrejtë midis numrit të karrigeve të autorizuara dhe numrit të pemëve që duhet të kontribuohen, me mundësinë e realizimit të këtij detyrimi në formë fizike ose në vlerë monetare.

Në nenin 7 rregullohet administrimi i fondit përmes krijimit të një regjistri elektronik të posaçëm, pjesë e sistemit e-leje, ku pasqyrohen të dhënat mbi mbjelljen, shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e fidanëve dhe pemëve, duke siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri.

Në nenin 8 parashikohet procedura e shpërndarjes së fondit, ku institucionet publike mund të përfitojnë fidanë dhe pemë nga Fondi i Gjellbër i Pemëve për projektet e tyre, nëpërmjet paraqitjes së kërkesave pranë AZHT-së, e cila vendos mbi bazën e prioriteteve të zhvillimit të territorit dhe nevojave për gjellbërim.

Në nenin 9 përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa në nenin 10 parashikohet hyrja në fuqi e tij pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij akti janë Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërië së Informacionit.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektvendimi është dërguar për mendim tek ministrinë e linjës, Ministrisë Së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektvendimi nuk parashikon të sjellë efekte shtesë për Buxhetin e Shtetit.

**MINISTRI**

**Enea Karakaçi**